

VENDIM
Nr. 55, datë 17.2.2026

**MBI KËRKESËN E SHOQËRISË “3AD ENERGY” SHPK PËR MARRJEN E
AUTORIZIMIT NGA ERE PËR VENDOSJEN E KUOTAVE SI MJET PËR
GARANTIMIN E PËRMBUSHJES SË DETYRIMIT NDAJ “FIRST INVESTMENT
BANK” SHA**

Në mbështetje të nenit 16 të ligjit nr. 43/2015, “Për sektorin e energjisë elektrike”, të ndryshuar; neneve 3 dhe 8 të rregullores “Për procedurat dhe afatet për dhënien e autorizimit nga ERE për ndryshimin e statusit ligjor të të licencuarit, ndryshimin e ortakut/aksionarit që kontrollon interesat e të licencuarit dhe vendosjen e kuotave/aksioneve të ortakut/aksionarit që kontrollon interesat e të licencuarit, si mjete për garantimin e përmbushjes së detyrimit/eve ndaj të tretëve”, miratuar me vendimin e Bordit të Entit Rregullator të Energjisë (ERE) nr. 235, datë 26.11.2021; si dhe nenit 15 të rregullores “Për organizimin, funksionimin dhe procedurat e ERE-s”, miratuar me vendimin e Bordit të ERE-s nr. 96, datë 17.6.2016; Bordi i ERE-s, në mbledhjen e tij të datës 17.2.2026, mbasi shqyrtoi relacionin me nr. 317/3 prot., datë 13.2.2026, të Drejtorisë së Licencimit, Autorizimeve dhe Garancisë së Origjinës, “Mbi kërkesën e shoqërisë ‘3AD Energy’ sh.p.k. për dhënien e autorizimit nga ERE për vendosjen e kuotave si mjet për garantimin e përmbushjes së detyrimit ndaj ‘First Investment Bank’ sh.a.”,

konstatoi se,

- Shoqëria “3AD Energy” sh.p.k., është licencuar me vendimin e Bordit të ERE-s nr. 1, datë 6.1.2025, në veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike nga centrali fotovoltaiik, me kapacitet të instaluar 2 mw, në zonën Sheq Marinas, Njësia Administrative Topojë, Bashkia Fier, qarku Fier.

- Me shkresën nr. 317 prot., datë 23.1.2026, shoqëria ka paraqitur aplikim dhe dokumentacion për marrjen e autorizimit nga ERE për vendosjen e kuotave të saj si mjet për të garantuar përmbushjen e detyrimit ndaj palës kredidhënëse “First Investment Bank” (FiBank) sh.a.

- Në kuadër të kësaj kërkeje dhe në mbështetje të dispozitave të “Rregullores për procedurat dhe afatet për dhënien e autorizimit nga ERE për ndryshimin e statusit ligjor të të licencuarit, ndryshimin e ortakut/aksionarit që kontrollon interesat e të licencuarit dhe vendosjen e kuotave/aksioneve të ortakut/aksionarit që kontrollon interesat e të licencuarit si mjete për garantimin e përmbushjes së detyrimit/eve ndaj të tretëve”, miratuar me vendimin e Bordit të ERE-s nr. 235, datë 26.11.2021, shoqëria ka depozituar, ndër të tjera: Kontratën e Kredisë Bankare nr. 4023 rep., nr. 1278 kol., datë 4.10.2024 dhe marrëveshjen siguruese nr. 4034 kol., nr. 1284 rep., datë 4.10.2024, ku citohet vendosja e pengut mbi 100% të kuotave të kredimarrësit.

- Konstatohet se si kontrata e kredisë, ashtu dhe marrëveshja siguruese rezultojnë të nënshkruara përpara se shoqëria të ishte licencuar nga ERE, pra përpara se shoqërisë t’i lindte detyrimi për të marrë autorizimin e ERE-s për këtë barrësim.

- ERE, me shkresën nr. 317/1 prot., datë 2.2.2026 dhe *email*-in e datës 12.2.2026, i ka kërkuar shoqërisë të informojë nëse është nënshkruar ndonjë marrëveshje siguruese vijuese me bankën pas licencimit në lidhje me barrësimin e kuotave.

- Në përgjigje me shkresën nr. 317/2 prot., datë 12.2.2026, shoqëria bëri me dije, se, përveç kontratës së kredisë bankare dhe marrëveshjes siguruese, të cilat janë vënë në dispozicion në kuadër të aplikimit, i licencuari, shoqëria “3AD Energy” sh.p.k. nuk ka nënshkruar asnjë marrëveshje tjetër me bankën në lidhje me barrësimin e kuotave.

- Si e tillë, vlerësohet se ERE nuk mund të marrë në shqyrtim kërkesën e shoqërisë për sa kohë marrëdhënia juridike me bankën për vendosje barrë siguruese është krijuar përpara se shoqëria të merrte statusin e të licencuarit dhe të lindnin detyrimet përkatëse në kuadër të këtij statusi.

Për gjithë sa më sipër, Bordi i ERE-s

VENDOSI:

1. Të mos marrë në shqyrtim kërkesën e shoqërisë “3AD Energy” sh.p.k. për marrjen e autorizimit të ERE-s për vendosjen e kuotave të kapitalit si mjet për garantimin e detyrimeve ndaj “First Investment Bank” sh.a.

2. Drejtoria e Licencimit, Autorizimeve dhe Garancisë së Origjinës, të njoftojë shoqërinë “3AD Energy” sh.p.k. për vendimin e Bordit të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Çdo palë e përfshirë në këtë procedurë mund t’i kërkojë ERE-s, brenda 7 ditëve kalendarike nga data e marrjes së vendimit, rishikimin e vendimit të Bordit, në rast se ka siguruar prova të reja që mund ta çojnë bordin në marrjen e një vendimi të ndryshëm nga i mëparshmi, apo për gabime materiale të konstatuara. Për këtë vendim mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative Tiranë, brenda 30 ditëve kalendarike nga dita e publikimit në Fletoren Zyrtare.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETAR
Petrit Ahmeti